



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d dhe 40 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4, si dhe nenin 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2021, miratoi këtë;

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS – NISMËS SË BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIMIT ME QYTETIN / KOMUNËN LINZ TË REPUBLIKËS SË AUSTRISË

Neni 1

Miratohet kërkesa – nisma e Kryetarit të Komunës së Podujevës, për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë.

Neni 2

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me përfaqësuesit e Qytetit / Komunës Linz të Republikës së Austrisë, dhe përgatitjen e draft Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot.01-016/01-0047903/21
Podujevë,
15 qershor 2021

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi

